# Kursi i KSP-së në nivel universiteti: përvoja norvegjeze

**Veronika Vakulenko**
As/profesor për kontabilitetin e drejtimit,
Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Nord, Norvegji

4 dhjetor 2024

WORLD BANK GROUP

NORD University

CFRR
Centre for Financial Reporting Reform
WORLD BANK GROUP

PULSAR
Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:

Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

# Konteksti: ngritja e arsimit për KSP-në

- ✓ Bashkëpunimi **mes Norvegjisë dhe Ukrainës prej vitit 2003**, me mbi 20 institucione të arsimit të lartë në Ukrainë.
- ✓ Projekti i parë ishte **riformimi profesional dhe përshtatja shoqërore** e veteranëve dhe familjeve të tyre.
- ✓ **Aleancat arsimore:**
  - Aleanca Universitare Norvegji-Ukrainë (AUNU) 2014
  - Rigjallëruar më 2023 me Aleancën Ukrainë-Norvegji për Arsim dhe Kërkim Shkencor (AUNAK)
- ✓ Projektet arsimore dhe kërkimore:
  - 2010-2015: *Bashkëpunimi Norvegjez-Ukrainas për Arsim dhe Kërkim në fushën e Administrimit të Qëndrueshëm*
  - 2014: *Integrim më i shpejtë në Komunitetin Evropian: vlerësimi i nevojave për përmirësim të aftësive të nëpunësve publikë të Ukrainës* – studim i realizueshmërisë për matjen e nevojave për përmirësim të aftësive të nëpunësve publikë dhe i prioriteteve të autoriteteve ukrainase në nivel qendror, rajonal dhe vendor, në ndihmë të integrimit evropian të Ukrainës.
  - 2014-2015: *Sektori publik: buxheti, kontabiliteti dhe financat*

Burimi: https://www.freepik.com/premium-vector/map-ukraine-design-ukraine-3d-map-design-vector-map_24670515.htm



# Konteksti: institucionalizimi i arsimit për KSP-në



- **2016-2019**: Projekti *"Bashkëpunimi Norvegjez-Ukrainas për Arsimin e Ekonomisë së Sektorit Publik: Kontabiliteti, Buxheti dhe Financat".*

- **Objektivat:**
  - Fuqizimi i partneritetit institucional në fushën e kontabilitetit, buxhetit dhe financave të sektorit publik, nëpërmjet bashkëpunimit akademik në arsimin dhe punën kërkimore mes Norvegjisë, Ukrainës dhe partnerëve ndërkombëtarë.
  - përfitimi nga bashkimi i forcave për nxitjen e bashkëpunimit rajonal mes institucioneve të arsimit të lartë në Ukrainë.

- **Rezultati kryesor: Harmonizimi dhe institucionalizimi i programeve studimore mes Fakultetit të Biznesit të Universitetit Nord dhe Universitetit Kombëtar Taras Shevçenko të Kievit,** me rezultat ngritjen dhe shfrytëzimin e një diplome të dyfishtë të nivelit master në shkenca për ekonomi

# Struktura e programit



- Cikli i dytë i studimeve në universitet
- I detyrueshëm për studentët e ESP-së
- I hapur vetëm për studentët e ESP-së

| Semestri I | Semestri II | Semestri III | | Semestri IV |
|---|---|---|---|---|
| **30 ECTS** | 30 ECTS | 30 ECTS | | 30 ECTS |
| **mësime në Bodo dhe Kiev (të njëjta)** | mësime në Bodo | mësime në Kiev | | në Bodo dhe Kiev Master<br><br>(në bashkëpunim me organizatat e sektorit publik në Norvegji dhe/ose Ukrainë)<br><br>Teza e diplomës me shkrim bëhet në Bodo<br>Prezantimi me gojë organizohet në Kiev/në mënyrë elektronike |
| | **Semestra të shkëmbimit** | | | |
| **VT308E<br>Teori e shkencës dhe metodikë (7,5 ECTS)** | ECO5003<br>Kontabiliteti publik & raportimi financiar sipas SNKSP-ve (7,5 ECTS) | Globalizimi dhe sistemet e financave kombëtare (7,5 ECTS) | | |
| **EK342E<br>Vlerësimi dhe analizë e rentabilitetit (7,5 ECTS)** | ECO5002<br>Matja e performancës në sektorin publik (7,5 ECTS) | Me zgjedhje (7,5 ECTS) | | |
| | | Investimet alternative dhe partneritetet publike-private (PPP) | Administrimi i portofolit | |
| **ORG5000<br>Proceset e novacionit dhe të ndryshimit (7,5 ECTS)** | ECO5015<br>Administrimi i rreziqeve dhe kontrolli i brendshëm (7,5 ECTS) | Me zgjedhje (7,5 ECTS) | | |
| | | Përgatitja dhe zbatimi i buxhetit | Siguria ekonomike dhe financiare e shtetit | |
| **ECO5004<br>Analiza strategjike (7,5 ECTS)** | EN313E<br>Qeverisja ndërkombëtare dhe biznesi në vendet nordike (7,5 ECTS) | Me zgjedhje (7,5 ECTS) | | |
| | | Modernizimi i sistemit të financave publike në ekonomitë në tranzicion | Menaxhimi financiar në organet e qeverisjes vendore | |

# **Ristrukturimi** i programit master



- **Ndryshimet nga 2024/2025:**
- **Module të reja:** qëndrueshmëria, perspektivat globale, udhëheqja e përgjegjshme dhe analiza tregtare.
- **Ristrukturim i programit mësimor** për t'i përshtatur lëndët bazë dhe ato me zgjedhje për të integruar rezultatet mësimore. Futja e lëndëve të përbashkëta me programe të tjera, për të rritur efikasitetin dhe bashkëpunimin.
- **Përputhshmëri me standardet e reja.**
  - Harmonizim me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare (BE) për zhvillimin e kontabilistëve publikë të autorizuar dhe audituesve të qëndrueshmërisë.
  - Integrimi i kërkesave ligjore dhe

NORD universitet / HHN Handelshøgskolen

## Diplomë shkencore e nivelit të dytë në biznes

| Semester 1 | Semester 2 | Semester 3 | Semester 4 |
|---|---|---|---|
| Global perspectives and sustainability | Management control | Method and scientific theory | Master thesis |
| Innovation and change processes | Business analytics | Major | |
| Responsible management and ethics | Performance Measurement in the Public Sector | Major | |
| Valuation and profitability analysis | Elective | Elective | |

ECO5003
Kontabiliteti publik & raportimi financiar sipas SNKSP-ve
(7,5 ECTS)

- Cikli i dytë i studimeve në universitet
- Me zgjedhje për të gjithë studentët
- E hapur për të gjithë studentët

# Struktura e kursit (1)



## Përmbajtja

- Kursi përbëhet nga dy pjesë të ndërlidhura.

- *Pjesa 1. Çështje teorike të kontabilitetit dhe raportimit financiar publik*

- Përqendrohet te prezantimi dhe trajtimi i bazave teorike kryesore të punës kërkimore-shkencore në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik. Krahas kësaj, trajtohen rrugët e reformave të kontabilitetit dhe zbatimi i SNKSP-ve në vendet e zhvilluara dhe vendet në zhvillim, roli i BSNKSP-së në krijimin e normave të kontabilitetit, krahasimi mes SNKSP-ve dhe SEKSP-ve, zbatimi dhe moszbatimi i standardeve të kontabilitetit të sektorit publik nga përdoruesit.

- *Pjesa 2. Studime teknike dhe empirike të kontabilitetit dhe raportimit financiar publik*

- Përqendrohet në SNKSP konkrete (p.sh., Paraqitja e informacioneve në brendi të pasqyrave ose në shënimet shpjeguese (SNKSP 1); AAM (SNKSP 17); Aktivet afatgjata jo-materiale (SNKSP 31); Zhvlerësimi i aktiveve (SNKSP 21 & 26); Pasivet dhe shpenzimet (SNKSP 39); Të ardhurat (nga veprime pa shkëmbim vlere dhe me shkëmbim vlerë), zbatimi praktik i tyre dhe dallimet kryesore me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

# Struktura e kursit (2)






## Raportimi i qëndrueshmërisë

- **Zhvillimi në kohë i raportimit** nga raportim financiar në raportim i integruar për qëndrueshmërir
- **Përbërësit bazë të raportimit të qëndrueshmërisë:** Mjedisor, social dhe qeverisje (MSQ) dhe vlerësimi i materialitetit dhe përfshirja e palëve të interesit.
- **Vështirësitë dhe mundësitë e sektorit publik:**
  - Harmonizimi i raportimit me OZHQ-të.
  - Trajtimi i drejtësisë mes brezave dhe i llogaridhënies publike.
  - Përshtatja e standardeve globale si BSNQ, DRQSH dhe BSNKSP për nevojat e sektorit publik.
- **Instrumentet praktike dhe qasjet**
  - Planifikimi strategjik dhe përgatitja e buxhetit në përputhje me qëndrueshmërinë.
  - Zhvillimi i treguesve të performancës për procesin e monitorimit.
  - Përfshirja e qëndrueshmërisë në vendimmarrje.
- **Raportimi i integruar:**
  - Ndërthurja e matësve financiarë me të qëndrueshmërisë.
  - Kritikat ndaj kornizave ekzistuese për mungesë të fokusit në nevojat e sektorit publik.
  - Vizion për raportim tërësor, të bazuar te palët e interesit.

# Fakte interesante



## Statistika

- Kurs aktiv prej vitit 2018 (7 vjet tashmë).
- Gjithsej, 134 studentë e kanë përfunduar kursin, prej të cilëve disa punojnë institucione financiare publike apo në shoqëri auditimi.

## Aktualiteti i kursit

- Mësimi i specialistëve të ardhshëm të Ukrainës dhe nxitja e reformave përkatëse të kontabilitetit në Ukrainën në rrugëtimin e saj drejt anëtarësimit në BE.
- Standarde ndërkombëtare që mund të jenë me rëndësi për kushtet e Norvegjisë, në bazë të zhvillimeve të fundit të KSP-së në përgjithësi dhe të qëndrueshmërisë në veçanti.
- Ndihmon në akreditimin pranë Shoqatës së Shkollave të Larta të Biznesit.

# Faleminderit!

WORLD BANK GROUP

CFRR
Centre for Financial Reporting Reform
WORLD BANK GROUP

PULSAR
Public Sector Accounting and Reporting Program

PULSAR Program is co-funded by:

Federal Ministry
Republic of Austria
Finance

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
**State Secretariat for Economic Affairs SECO**